




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të nenit 8 paragrafi (1)(2) dhe (3) të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtëshme të Komunës Ligji Nr.04/L-144 dhe Rregullores Komunale për procedurat e dhënies së objekteve të Komunës dhe tokës në shfrytëzim përmes ankandeve, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.01.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUJTËSHME TË KOMUNËS

I.

Formohet Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së palujtëshme të Komunës, në këtë përbërje:

Mehmet Osaj (AAK), Besjana Ukëhaxhaj(AAK), Fatmir Kurmehaj(LDK), Safete Gacaferi OJQ), Izet Zenuni nga Ekzekutivi, Agron Demukaj nga Ekzekutivi, Dyke Lllolluni nga Ekzekutivi.

Kryetarin e zgjedhin anëtarët e Komisionit nga radhët e veta në mbledhjen e parë

II.

Komisioni Vlerësues detyrat dhe përgjegjësitë e veta do ti ushtroj në pajtim me Ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtëshme të Komunës dhe Rregulloren Komunale për procedurat e dhënies së objekteve të Komunës dhe tokës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandeve.

III.

Mandati i anëtarëve të këtij komisioni zgjatë aq sa zgjatë mandati i rregullt ligjorë i përbërjes së këtij Kuvendi.

IV.

Komisioni për detyrat dhe obligimet e veta i përgjigjet drejtpërsëdrejti Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës.

V.

Për punën e vet komisioni do të paguhet nga 50 për takim.

VI.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.I-12

Deçan,dt.31.01.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit: Haki Shehaj

Stampa e Kuvendit të Komunës së Deçanit me datë 01.02.18 dhe numër 3798.